



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr. 24/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore të evidentuar P. nr 968/20, ndaj përmbarduesit privat [REDACTED], si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në [REDACTED] pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, përfaqësuesja e Divizionit për Mbikëqyrjen e Profesioneve të Lira nga Ministria e Drejtësisë znj. Albulena Uka dhe përmbarduesit privat, [REDACTED] dhe pas seancës këshillimore, me datën 11.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, DPL-24/2021, datë 28.06.2021, dhe Raporti i Divizionit për Mbikëqyrjen e Profesioneve të Lira nga Ministria e Drejtësisë të 17.08.2021 dhe Ankesa e [REDACTED] dt 21.06.2021, si të pa bazuara.
- II. Organi përmbardues-Përmbarduesit Privat, [REDACTED] nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra përmbardimore në lëndën përmbardimore P. nr 968/20.

A r s y e t i m

Me datën 21.06.2021, pala ankuese [REDACTED] ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë ndaj përmbarduesit privat [REDACTED], i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në [REDACTED]. Sipas palës ankuese, përmbarduesi privat ka zbatuar përmbardimin në lëndën P.

nr 968/20 mbi bazën e faturave duke i bllokuar llogaritë bankare i ka shkaktuar dëme të pariparueshme në kompani edhe pse ankesa ekziston në Gjykatën e Apelit pas refuzimit të prapësimit të debitorit nga Gjykata Themelore në Gjiilan. Me dt 17.08.2021, Divizioni për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira (tani e tutje Divizioni) ka paraqitur Raportit lidhur me lëndën përmbartimore P. nr 968/20. Raporti thekson se urdhri për caktimin e përmbartimit dt 18.09.2020, në bazë të faturave, ku njëra nga faturat me nr 1456/20 dt 15.07.2020 nuk përmban nënshkrimin e palës debitore është në kundërshtim me nenin 29 par 1, të LPP. Po ashtu propozimi thekson se urdhri për caktimin e përmbartimit i nxjerrë nga përmbartuesi me dt 18.09.2020 për lëndën P. nr 968/20 nuk tregon dokumentin e besueshëm në bazë të së cilës urdhërohet përmbartimi dhe nuk përmban as elementin tjetër i cili është kredia që duhet të realizohet. Sipas propozimit, urdhëri për caktimin e përmbartimit përfshinë shpenzimet e kreditorit prej 76.7 euro dhe shumën prej 35.40 euro për urdhrin përfundimtar. Megjithatë, parashtuesi pretendon që shuma prej 35.40 euro në emër të urdhrit përmbartimor është e paqartë se për cilin urdhër është bërë llogaritja sepse një urdhër përfundimtar nuk është nxjerrë deri në këtë fazë të procedurës përmbartimore dhe nuk është pjesë e shkresave të lëndës.

Me 25.08.2021, Departamenti për Profesion të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, mbi bazën e ankesës së paraqitur nga pala ankuese dhe Raportit nga Divizioni ka ngritur në Komisionin Disiplinor propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbartuesit privat [REDAKTUAR], i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në [REDAKTUAR] dhe ka propozuar ndërmarrjen e veprimeve ligjore ndaj tij.

Përmbartuesi privat [REDAKTUAR] në përgjigjen e tij me shkrim deklaroi se ka zbatuar përmbartimin në lëndën P.nr 968/20 në pajtim me ligjin. Pala debitore ka paraqitur prapësimin i cili më aktvendimin CPK. Nr 121/21 dt 24.05.2021 është refuzuar si i pabazuar nga Gjykata Themelore në Gjiilan. Ankesa ndaj aktvendimit mbi refuzimin e përmbartimit nuk ka ndalon zbatimin e përmbartimit përveç nëse pala debitore bënë deponimin e garancionit bankare në shumën e plotë të borxhit. Në këtë rast, përmbartuesi privat thekson, se një garancion i tillë nuk është bërë. Për sa i përket lejimit të përmbartimit, sipas përmbartuesit privat, neni 29 par 3 i LPP përcakton që “dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se është treguar kreditori dhe debitori, objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar.” Të gjitha faturat mbi bazën e së cilave është zbatuar përmbartimi kanë elementet që i kërkon ligji. Lidhur me nënshkrimet në fatura, përmbartuesi privat thekson se pala debitore ka ushtruar prapësim i cili është refuzuar nga Gjykata. Kurse sa i përket asaj se urdhëri nuk tregon dokumentin në bazë të cilit urdhërohet përmbartimi, përmbartuesi privat thekson se sipas nenit 44 të LPP, urdhri për përmbartim nuk ka nevojë që të përshkruaj apo citoj dokumentin e besueshëm por mundet vetëm me vulë katrore të lejohet propozimi për përmbartim. Lidhur me shpenzimet, përmbartuesi privat thekson se në rastet kur mbyllet borxhi brenda 7 ditësh atëherë shpenzimet e procedurës përmbartimore janë: taksa për administrim, taksa për lejimin e përmbartimit, shpenzimet e ekspeditimit të shkresave dhe konform nenit 66 pika 4 të LPP duhet të nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore për përpilimin e të cilit është shuma prej 20 euro, ndërsa shuma prej 10 euro në emër të dërgimit të shkresave tek palët që së bashku me TVSH arrijnë shumën prej 35.40 euro.

Divizioni ka paraqitur kundërpërgjigje në përgjigjen e përmbartuesit privat duke theksuar se pretendimet e përmbartuesit privat nuk janë të bazuara.

Me datën 11.10.2021, Komisioni Disiplinor ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, znj, Fadilete Hoxha, përfaqësuesi i Divizionit nga Ministria e Drejtësisë znj. Albulena Uka dhe përmbartuesit privat, [REDACTED]

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, znj, Fadilete Hoxha, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbartuesit privat duke theksuar se mbetet pranë propozimit. Po ashtu edhe përfaqësuesi Divizionit nga Ministria e Drejtësisë znj. Albulena Uka ka ngjelur pranë Raportit të paraqitur me shkrim si dhe ka bërë eleborimin e saj. Përmbartuesi privat z. [REDACTED] gjithashtu kanë paraqitur qëndrimin e tij lidhur me pretendimet e ngritura duke kërkuar refuzimin e saj.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se përmbartuesi privat nuk ka kryer vepër disiplinore.

Komisioni Disiplinor gjen me rëndësi të thekson se, në thelb, parashtruesi pretendon se përmbartuesi privat ka vepruar në kundërshtim me ligjin në dy mënyra: fillimisht sepse fatura mbi bazën e të cilës është nxjerrë urdhëri për caktimin e përmbartimit, konkretisht fatura nr [REDACTED] e datës 15.07.2020 nuk përmban nënshkrimin e palës debitore si pranuese e faturës dhe si e tillë fatura nuk i plotëson tiparet e përmbartueshmërisë sipas nenit 29 par 1 dhe nën par 1.3 të LPP, dhe e dyta; parashtruesi thekson që urdhëri për caktimin e përmbartimit përfshinë shpenzimet e kreditorit në shumën prej 76.7 euro dhe urdhri përfundimtar shumën prej 35.40 euro, ku kjo e fundit është e paqartë se për cilin urdhër është bërë llogaritja për faktin se një urdhër përfundimtar nuk është nxjerrë deri në këtë fazë të procedurës përmbartimore dhe nuk është pjesë e shkresave të lëndës.

Për sa i përket rregullsisë së dokumentit përmbartimor, Komisioni Disiplinor i referohet vendimit të Gjykatës e Apelit Ac. Nr 2922/2019, në të cilën është theksuar që dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të *‘është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar bazuar në nenin 29 par 3 të LPP’* dhe se *‘fatura në minimum, duhet të jetë nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore sipas nenit 20 par 1 nën par 1.17 të Udhëzimit Administrativ 15/2010 për zbatimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat’* Si rezultat, Komisioni Disiplinor vlerëson gjykata e apelit ka përcaktuar se fatura duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi dhe po ashtu edhe nga klienti apo blerësi kur i njëjti është në dispozicion. Se kur konsiderohet se është në dispozicion klienti apo blerësi, në vlerësimin e Komisionit Disiplinor, është çështje faktike që duhet të konstatohet rast pas rasti duke marrë parasysh të gjitha rrethanat. Në rastin konkret, fatura është e nënshkruar nga shitësi po jo edhe nga blerësi- Pala ankuese [REDACTED] Sidoqoftë, ndryshe nga parashtruesi i propozimit për fillimin e procedurës disiplinore, pala ankuese në ankesën e paraqitur me datën 21.06.2021, edhe pse nuk ka nënshkruar, ajo nuk e kundërshton rregullsinë e faturës. Pala ankuese thekson që përmbartuesi privat ka bllokuar llogaritë e tij edhe pse ka paraqitur ankesë kundër vendimit mbi refuzimin e prapsimit. Rrjedhimisht, për aq kohë sa fatura nuk kontestohet as nga

vet pala ankuese dhe pretendimet lidhur mos rregullsinë e urdhrin përmbartimor janë adresuar në përmes prapësimit në gjykatën kompetente, Komisioni Disiplinor çmon si jo lëndore të jap vlerësimit e tij përkitazi nënshkrimit respektivisht mos nënshkrimit e faturës nga ana e palës debitore në rastin konkret. Ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbartimore, Komisioni Disiplinor gjen se taksa për urdhrin e përfundimit të lëndës është njëzet (20) euro, shuma prej dhjetë (10) euro lidhet më dërgimin e shkresave palëve, që së bashku me TVSH arrijnë vlerën prej 35.40 euro. Në vlerësimin e Komisionit Disiplinor, përmbartuesi privat nuk ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ nr 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore apo Udhëzimin Administrativ MD. Nr 01/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MD. Nr 06/2014 Për Tarifat, Shpërblimet dhe Kompensimin e Shpenzimeve për Përmbartuesit privat,

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARTUESIT PRIVAT
DPL.nr 24/2021, datë 11.10.2021

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.